

Historia e Nikollës dhe Elenës

Nikolla dhe Elena kanë pasur një martesë të lumtur për 10 vjet dhe kanë tre fëmijë. Ata që të dy duan që familja e tyre të ngrihet mbi themelin e Jezu Krishtit dhe të ungjillit të Tij, dhe ata të gjithë përpiqen fort për të përmbushur përgjegjësitë e tyre familjare, të caktuara në mënyrë hyjnore.

Si çiftet e tjera të martuara, Nikolla dhe Elena kanë mosmarrëveshje. Mosmarrëveshjet e tyre janë zakonisht rreth parave. Nikolla punon me kohë të plotë jashtë shtëpisë. Elena është të gjendje të kujdeset për fëmijët e tyre dhe për shtëpinë gjatë gjithë kohës, përveç faktit që punon herë pas here në disa punë të vogla. Nikolla beson se roli i tij në kryesimin në shtëpi, si edhe fakti që ai është personi që siguron më shumë para, do të thotë që ai duhet të jetë personi që merr vendimin përfundimtar lidhur me mënyrën se si të shpenzohen paratë e tyre. Elena e ndien se ajo duhet të ketë më shumë fuqi në vendimet që përfshijnë fëmijët ngaqë ajo është me ta më shumë se Nikolla. Nganjëherë në të shkuarën, pa i thënë Nikollës, ajo i ka shpenzuar paratë e tyre sipas mënyrës që dëshiron.

Nikolla dhe Elena kohët e fundit kanë qenë duke diskutuar se çfarë të bëjnë me disa nga paratë që kanë kursyer. Nikolla do të donte t'i përdorte për të blerë një makinë që do ta bënte më të lehtë për të që të shkonte në punë dhe për familjen e tyre që të lëviznin. Elena do të donte t'i përdorte paratë për t'i çuar fëmijët me pushime që të vizitonin të afërmit e tyre dhe të kishin disa përvoja argëtuese së bashku përpara se fëmijët të rriteshin më shumë në moshë.

Mosmarrëveshja e Nikollës dhe Elenës i ka rënduar shumë, por duhet të merret një vendim.

- Çfarë do të thoshit se është sfida më e madhe që po hasin Nikolla dhe Elena në vendimin se çfarë të bëjnë me paratë?
- Çfarë mendoni se u nevojitet që të kuptojnë më mirë rreth bashkëpjesëmarrjes së barabartë dhe kryesimit në lidhje me marrjen e vendimeve për familjen e tyre? (Shih pjesën 3 të materialit të përgatitjes.)
- Nëse do të ishit Nikolla ose Elena, si do t'i drejtoheshit bashkëshortes/it tuaj që të këshilloheshit së bashku rreth këtij vendimi në një mënyrë si ajo e Krishtit?